

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Nadiafarm” SH.P.K.

Sot, më date **10.12.2020**, une e nenshkruara:

- **Nadire (Kadri) Hazizi** lindur me 07/03/1964, shtetase shqiptare, me residence ne Fier, fshati Strum, mbajtese e leternjoftimit nr. **031338479**, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar...; në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare” kemi vendosur të themelojme një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar “**Nadiafarm**” **SH.P.K.** (më poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi dhe i bashkëngjitet si Shtojca 1.

Neni 1

Emri i Shoqërisë është: “**Nadiafarm**” **SH.P.K.**

Neni 2

(1) Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Fshati Strum, pasuria me nr.118/6, zona kadastrale 3532, Qarku Fier. Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithe vendin.

(2) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: *hazizinadire@gmail.com*
Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

Neni 3

-Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë 10 vjet dhe fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Neni 4

Objekti

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm :

b. Prodhim te produkteve bujqesore ne ambjente te mbrojtura (sera) dhe fushe te hapur, etj

-Megjitheate shoqëria ka te drejte qe te shtoje dhe te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj me vendim te asamblese se ortakeve.

Neni 5

Kapitali themeltar

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **100.000** (Njeqind mije) Lekë



Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
1. Ortakja themeluese **Znj. Nadire Hazizi**: Zotëruese e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej **100.000** (Njeqinde mije) Leke që përbën **100 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
Kontributi i ortakëve do të jetë në para.

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Shtimi ose pakësimi i kapitalit themelor mund të bëhet vetëm pasi Asambleja e ortakëve me shumicë e ka dekretuar këtë dhe për më tepër të gjithë ortakët janë të detyruar që ta repektojnë dhe të kontribuojnë në para ose në natyrë në bazë të vendimit të shumicës së asmblesë

Neni 7:

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen përmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) shitblerjes;(me të drejtën e parablerjes nga ana e ortakëve).
- c) trashëgimise;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjrisht të transferueshme ndërmjet ortakëve,përsa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitakit themeltare janë ligjrisht të transferueshme me rrugë trashgimnie.

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi, marrja e vendimeve ,përfashtimi nga e drejta e votës dhe të tjera modalitete për funksionimin e organit vendimmarres përcaktohen në statutin e shoqërisë.

Neni 9

Administrimi



Aministratore e shoqerise emerohet Znj. **Nadire Hazizi** lindur me 07/03/1964, shtetase shqiptare, me residence ne Fier, fshati Strum, mbajtese e leternjoftimit nr.**031338479**, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i zgjedhur per nje periudhe **5** vjecare me te drejte rizgjedhje.

Kompetencat dhe pergjegjesite e Administratorit jane te percaktuara qarte ne statutin e shoqerise.

Neni 10

Viti financiar-ekspertët

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxierien e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cialt është i detyruar që tja paraqesë e ta dorëzojë në kohë ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 11

Prishja-riorganizimi i shoqërisë

Modalitetet per prishjen dhe riorganizimin e shoqerise jane te percaktuara ne statutin e shoqerise ne përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 12

Akti i Themelimit eshte hartuar ne 4 kopje origjinale.

ORTAKU I VETEM

Nadire Hazizi

Nadine Hazizi
[Signature]
2020